



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 108

Tiranë – E mërkurë, 7 korrik 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 6.7.2021	Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Overseas LLC</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin.....
	9991
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 30.6.2021	Për përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....
	9991
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 30.6.2021	Për miratimin e rregullave të detajuara për personat juridikë nënkontraktorë, që kryejnë operacione hidrokarbure.....
	9992
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 398, datë 30.6.2021	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për sigurinë 4G dhe 5G.....
	9993
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.6.2021	Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve.....
	9995
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 6.7.2021	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Lushnjë, z. Fatos Tushe.....
	10021



		ngjashëm brenda ose jashtë vendit dhe ushtron detyrën e tij në një funksion organik në strukturën e FA-së (Forca Ajrore), në përputhje me formimin (diplomën) e fituar.
4.	Motorist në anije	“Motorist në anije” – nënoficeri, i cili ka kryer të paktën arsimin e mesëm profesional brenda ose jashtë vendit ose ka kryer kurs/trajnim dhe është certifikuar si motorist/mekanik nga Qendra e Formimit Profesional dhe ushtron detyrën e tij në funksionin motorist/kryemotorist/elektricitist i motorëve ndihmues në anije ose instruktor i përgatitjes mekanike (motorist) në Qendrën Stërvitore Bazë Detare, në Forcën Detare.

VENDIM**Nr. 397, datë 30.6.2021**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
DETAJUARA PËR PERSONAT JURIDIKË
NËNKONTRAKTORË, QË KRYEJNË
OPERACIONE HIDROKARBURE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e rregullave të detajuara, që do të zbatohen për personat juridikë nënkontraktorë, në kuptim të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, të cilët, direkt ose indirekt, kryejnë operacione hidrokarbure në përputhje me legjislacionin në fuqi për hidrokarburet, ku përfshihen kërkimi dhe prodhimi, si dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3, të nenit 2, të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.

2. Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 4, të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Aktivitet thelbësor i një operacioni hidrokarbur”**, një ose disa operacione hidrokarbure të realizuara nga personat juridikë nënkontraktorë, kur niveli i kontributit të faturimeve të këtij personi juridik në totalin e shpenzimeve për operacionet hidrokarbure të personit të autorizuar është jo më pak se 25 (njëzet e pesë) %;

b) **“Persona të lidhur”**, i njëjti kuptim i dhënë nga neni 2, i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

c) **“Operacionet hidrokarbure”**, të gjitha operacionet dhe çdo operacion që lidhet me kërkimin, vlerësimin e një zbulimi, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, ndarjen e trajtimin, grumbullimin, transportimin dhe shitjen ose disponimin e hidrokarbureve deri në pikën e eksportit ose në një pikë lëvrimi në Shqipëri, për të cilën është rënë dakord, ose në pikën e hyrjes në një rafineri dhe përfshin operacionet e përpunimit të gazit natyror, por nuk përfshin operacionet e përpunimit të hidrokarbureve, të cilat janë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për hidrokarburet.

3. Në rastin kur shpenzimet për operacionet hidrokarbure të faturuara ndaj personit të autorizuar nga nënkontraktori janë jo më pak se 25 (njëzet e pesë) % e totalit të shpenzimeve për operacionet hidrokarbure, nënkontraktori ose nënkontraktorët u nënshtrohen dispozitave në fuqi të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, dhe paguajnë tatim mbi fitimin në normën tatimore 50 (pesëdhjetë) %. Llogaritja e shpenzimeve për operacionet hidrokarbure, nga nënkontraktori për kontraktorin, bëhet mbi bazën e vlerës totale në lekë të faturave të lëshuara nga nënkontraktori pa TVSH. Nëse vlera e shpenzimeve pa TVSH e llogaritur si më sipër përbën jo më pak se 25 (njëzet e pesë) % të totalit të shpenzimeve të kontraktorit, nënkontraktori tatohet me normën tatimore 50 (pesëdhjetë) % për këtë pjesë të aktivitetit apo të veprimtarisë së tij.

4. Administrata tatimore, në bashkëpunim me AKBN-në, analizon përputhshmërinë e marrëveshjeve dhe të kontratave të lidhura ndërmjet kontraktorit dhe nënkontraktorit me parashikimet/rregullimet e legjislacionit në fuqi për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur dhe tatimin mbi të ardhurat, me qëllim identifikimin e rasteve kur synohet shmangia nga nënkontraktori i pagesës së tatimit, sipas normës tatimore të përcaktuar në



ligjin nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.

5. Në rastet kur, në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi, evidentohet se kontraktori dhe/ose nënkontraktorët kryejnë një ose një sërë veprimesh apo transaksionesh direkte apo indirekte, që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, veprimi apo transaksioni rikarakterizohet nga administrata tatimore dhe detyrimi i ri tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat në fuqi për vlerësimin tatimor alternativ, të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.

6. Vendimi përfundimtar për normën tatimore të aplikueshme për nënkontraktorët, në zbatim të pikës 5, të këtij vendimi, merret nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkërendim me drejtorinë rajonale tatimore, ku janë të regjistruar personat juridikë nënkontraktorë.

7. Me qëllim zbatimin e këtij vendimi, administrata tatimore bashkëpunon e bashkërendon punët me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), sipas funksioneve dhe veprimtarisë së tyre, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur.

8. Ngarkohen Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 398, datë 30.6.2021

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS, PËR
SIGURINË 4G DHE 5G**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me

propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për sigurinë 4G dhe 5G, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA
PËR SIGURINË 4G DHE 5G**

Duke marrë parasysh që rrjetet e sigurta të gjeneratës së pestë (5G) do të jenë me rëndësi jetike si për prosperitetin e ardhshëm ashtu dhe sigurinë kombëtare dhe që vendimet e marra në lidhje me rrjetet e komunikimit pa tel të gjeneratës së katërt (4G) do të paraqesin implikime serioze për instalimet e ardhshme të 5G, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara shprehin dëshirën e tyre për të forcuar bashkëpunimin e tyre për 4G dhe 5G. 5G do të mundësojë një gamë të gjerë aplikimesh të reja, përfshirë edhe ofrimin e shërbimeve kritike për publikun, të cilat do të jenë në interes të qytetarëve tanë dhe ekonomive tona. Rritja në sasi dhe përhapja e pakufizuar e të dhënave në rrjetet 5G do të ndërlidhin më tej ekonominë e botës, përfshirë Shqipërinë dhe Shtetet e Bashkuara, dhe do të lehtësojnë shërbimet dhe tregtinë ndërkufitare. Si aleatë të NATO-s, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara kuptojnë se përdorimi i rrjeteve 5G të prodhuara nga prodhues jo të besueshëm mund të rrezikojë ndërveprimin ushtarak dhe civil dhe mundësitë e shkëmbimit të dhënave të inteligjencës. Mbrojtja e këtyre rrjeteve të komunikimit të gjeneratës së ardhshme nga ndërhyrja ose manipulimi dhe garantimi i sigurisë, privatisë dhe lirive individuale të qytetarëve të Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara janë me rëndësi jetike për të siguruar që popujt tanë të